



Prishtinë, 09 shkurt 2017
Kodi i ZRRE-së: V_885_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-770-2016 të datës 28 janar 2016 të lëshuar shoqërisë "AFA Energy" SH.P.K., me të cilën ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Kotlina 2, në Lumin Kotlinë, ZK Kotlinë, me kapacitet të instaluar prej 2.7 MW, Komuna e Hanit të Elezit, Republika e Kosovës, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Kotlina 2, në Lumin Kotlinë, ZK Kotlinë, me kapacitet të instaluar prej 2.7 MW, Komuna e Hanit të Elezit, të datës 24.01.2017, të shoqërisë "AFA Energy" SH.P.K., me adresë: Rruga "Lagjja Ariu" Nr. 10, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 09 shkurt 2017 nxori këtë:


V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_770_2016 i datës 28 janar 2016, i lëshuar shoqërisë "AFA Energy" SH.P.K., për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 28 korrik 2017**.
- II. Shoqëria "AFA Energy" SH.P.K., obligohet që brenda këtij afati të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Kotlina 2, në Lumin Kotlinë, ZK Kotlinë, me kapacitet të instaluar prej 2.7 MW, Komuna e Hanit të Elezit, gjegjësisht deri me datën **28 korrik 2017** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- III. Pas skadimit të afatit si në pikën I. të dispozitivit, Vendimi V-770-2016 i datës 28 shkurt 2016 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.



Arsyetim

- ZRRE, me datë 12.06.2015 nga shoqëria “AFA Energy” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Kotlina 2, në Lumin Kotlinë, ZK Kotlinë, me kapacitet të instaluar prej 2.4 MW, Komuna e Hanit të Elezit, Republika e Kosovës.
- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 28 janar 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_770_2016, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_770_2016, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse.
- Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar se aplikuesit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesit Publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (1) një vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria “AFA Energy” SH.P.K., do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- Aplikuesi “AFA Energy” SH.P.K., me datë 24.01.2017 ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: që nga marrja e vendimit për autorizimin preliminar janë angazhuar në kompletimin e dokumenteve të kërkuara (Lejen ndërtimore, Pëlqimit Ujor, Lejen Ujore, Pëlqimin Elektroenergjetik dhe burimet financiare).
- Poashtu, ka sqaruar se gjatë kompletimit të dokumenteve të sipërcekura deri më sot kanë aplikuar dhe janë në proces të marrjes së Lejes së ndërtimit për të cilën dokumentacioni është i kompletuar por është i lidhur me Pëlqimin nga Agjencioni i Pyjeve për marrje të pronës me qera deri në fund të janarit 2017, kanë aplikuar për Pëlqimi Urbanistik (nr. 06-350-2017 dt. 23.01.2017), për Pëlqim Elektroenergjetik (nr. 90716 dt. 08.12.2016 dhe për mbështetje financiare me dt. 19.09.2016, për lëshimin e pëlqimeve në fjalë janë në pritje të përgjigjeve nga organet kompetente.
- Andaj, bazua në këto dëshmi, kanë kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që të lejoj shtyerjen e afatit të vlefshmërisë së vendimit të autorizimit preliminar edhe për gjashtë (6) muaj, për kompletimin e pozicioneve dhe marrjen e Autorizimit Final për ndërtim. Gjithashtu kërkesës iu janë bashkangjitur dëshmitë e siguruara deri më tani dhe atë: Pëlqimi Mjedisor; 15/39996/1-417/DMM dt. 28.09.2016, Pëlqimi Ujor 650//16 – ZSP -237/2016 dt. 01.03.2016



dhe dëshmitë e lartcekura për kompletim të dokumentacionit për marrje të Lejes ndërtimore nga organi kompetent.


- ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:



Krenar Bujupi, u.d kryesues



Arsim Janova, anëtar



Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Hanit të Elezit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.